



RREGULLORE PËR PUNËN E KËSHILLIT PROFESIONAL



Në bazë të pikës 6.5 të Statutit të Federatës së Sportit Shkollor, Bordi i FSSHRK-së, në mbledhjen e mbajtur më 13.10.2022, mori vendim për miratimin e rregullores së Këshillit Profesional për shkollat e mesme të ulëta dhe të larta:

RREGULLORE

PËR PUNËN E KËSHILLIT PROFESIONAL

Dispozitat themelore

Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohet mënyra e punës së këshillit profesional.

Neni 2

Përbërja, kompetencat dhe fusha e veprimit të këshillit profesional rregullohen me Statutin e FSSHRK-së

Neni 3

Në Këshillin Profesional mund të zgjidhen personat të cilët janë mësimdhënës të Edukatës Fizike dhe Sportit, dashamir të sportit të cilët kanë emrues të përbashkët me sportin, si dhe që ka fituar votat e shumicës së anëtareve të Bordit 50+1%.

Neni 4

Mandati i Këshillit Profesional zgjatë katër vjet, prej momentit të emërimit të ti nga Bordi i FSSHRK-së



Neni 5

Këshilli Profesional në fushë veprimin e vetë kryen këto punë:

- Këshilli Profesional cakton kalendarin e garave në ato sporte të cilat janë me prioritet për vendin, dhe të cilat janë në përputhje me garat të cilat i organizon **”ISF”-ja**
- Këshilli Profesional cakton vendin e mbajtjes së garave në nivel Regjional dhe Republikan për të gjitha sportet prioritare.
- Harton rregulloret e garave për për të gjitha sportet e caktuara nga bordi

Neni 6

Për punën e vetë Këshilli Profesional i përgjigjet Bordit si dhe merr udhëzime nga Bordi.

Neni 7

Këshilli Profesional për punën e vetë duhet të paguhet me meditje të cilat i cakton Bordi.

MËNYRA E VENDOSJES

Neni 8

Votimi në mbledhje është i hapur. Anëtarët e Këshillit Profesional duhet të votojnë “PËR”, pastaj “KUNDËR” ose “PËRMBAHEM NGA VOTIMI”.

Së pari thirren të votojnë ata që janë “PËR”, pas tyre ata që janë “KUNDËR” e në fund ata që ”PËRMBAHEN”

Neni 9

Kjo Rregullore hyn në fuqi nga dita e miratimit të saj.

Neni 10

Interpretimin e kësaj Rregulloreje e bënë Bordi i FSSHRK-së.

Prishtinë

13.10.2022

Kryetari i FSSHRK-së

Adrian TELAKU prof.